



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 14.02.2025

Nr: 102

Ora: 12:00

VENDIM

**PËR FILLIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE BAZUAR NË
DENONCIMIN NR. 5, DATË 10.02.2025, TË REGJISTRIT TË DENONCIMEVE,
TË PARTISË DEMOKRATIKE**

Sot më datë 14.02.2025, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi mori në shqyrtim paraprak denoncimin me:

KËRKUES: Partia Demokratike

SUBJEKT: Zj. Ogerta Manesterliu
Ministër i Arsimit dhe Sportit

Zj. Mirela Kumbaro
Ministër i Turizmit dhe Mjedisit

Z. Bledi Çuci
Zëvendëskryetar i Kuvendit të Shqipërisë

Z.Taulant Balla
Ministër i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin

Zj. Belinda Balluku
Zëvendëskryeministër, Ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë

OBJEKT: Konstatimi i shpërdorimit të burimeve publike dhe njerëzore në mbështetje të subjekteve zgjedhore, angazhimi në fushatë zgjedhore para afatit të caktuar me ligj

BAZA LIGJORE: Neni 91, pikat 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, dhe 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neni 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 09.03.2021, të Komisionit Rregullator

KONSTATOJ:

Data: 14.02.2025

Nr: 102
Ora: 12:00



“Për fillimin e procedurës administrative bazuar në denoncimin nr. 5, datë 10.02.2025, të regjistrit të denoncimeve, të Partisë Demokratike”

Partia Demokratike më datë 10.02.2025, ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) nëpërmjet adresës së postës elektronike e-mail, denoncimin e administruar në regjistrin e denoncimeve me nr. 5 ID.

Në këtë denoncim Partia Demokratike parashtron sa vijon:

“Nga denoncimet dhe raportimet e publikuara në media të ndryshme, Partia Demokratike ka konstatuar se drejtuesit politik të PS-së në disa qarqe si Belinda Balluku, Ogerta Manasterliu, Mirela Kumbaro dhe Bledi Çuci kanë qënë në Athinë dhe Janinë ku janë hapur zyra informuese për të asistuar të gjithë shqiptarët që jetojnë jashtë vendit për të marrë pjesë në zgjedhjet e 11 majit.

Bledi Çuci ka publikuar në llogarinë e tij foto nga takimi ku shihet se është krijuar një zyrë asistence. Krahas fotove, Bledi Çuci “Athinë - Në zyrën e hapur këtu në Atikën veriore ku ka nisur regjistrimi i votuesve jashtë vendit. Kushdo që nuk e kryen dot vetë këtë regjistrim në faqen e KQZ le të paraqitet në këto zyra për asistencë”. Ministri i Shtetit Taulant Balla në rrjetin e tij social instagram ka publikuar se në datë 18 Janar 2025, ora 11:00 do të gjendet në Rimini, Itali, për të takuar shqiptarët”.

Nga sa më sipër çmoj se, ekzistojnë kushtet për t’u nisur hetimi administrativ.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve,

V E N D O S:

1. Fillimin e procedurës administrative ndaj:

- Zj. Belinda Balluku, Zëvendëskryeministër, Ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë;
- Zj. Ogerta Manasterliu, Ministër i Arsimit dhe Sportit;
- Zj. Mirela Kumbaro, Ministër i Turizmit dhe Mjedisit;
- Z. Bledi Çuci, Zëvendëskryetarë i Kuvendit të Shqipërisë;
- Z.Taulant Balla, Ministër i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin.

2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet adresës së postës elektronike.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI